



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR

NJOFTIM

PER PRANIMET NE CIKLIN E DYTE TE STUDIMEVE "MASTER PROFESIONAL" DHE "MASTER I SHKENCAVE" PËR VITIN AKADEMIK 2016-2017

Ju njoftojmë se aplikimet në programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë në Universitetin "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, fillojnë nga data 07 tetor 2016 deri në datën 12 tetor 2016.

Programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë që ofrohen janë si më poshtë:

"MASTER PROFESIONAL":

Mesuesi per Arsimin e Mesem te Ulet ne

1.	Matematike-Fizike, me profil minor ne Aftesim Teknologjik
2.	Matematike-Informatike, me profil minor ne Aftesim Teknologjik
3.	Biologji-Kimi, me profil minor ne Edukimin Mjedisor e Teknologjik
4.	Histori-Gjeografi, me profil minor ne Edukaten Shoqerore
5.	Gjuhe-Letersi, me profil minor ne Gjuhe Italiane
6.	Gjuhe Angleze me profil minor ne Gjuhe Shqipe
7.	Gjuhe dhe Qyteterimin Italian me profil minor ne Gjuhe Shqipe
8.	Gjuhe, Letersi dhe Qyteterim Grek me profil minor ne Lende Shoqerore

"MASTER PROFESIONAL" ne

9.	Kontabilitet-Finance
10.	Administrim-Publik
11.	Turizem

"MASTER SHKENCOR" ne

1.	Arkeologji dhe Administrim i Pasurive Arkeologjike
2.	Gjuhesi
3.	Letersi
4.	Mesuesi per arsimin fillor,Klasa I-VI
5.	Biologji Mjedisi dhe Zhvillimi

Kandidati paraqitet personalisht dhe dorezon dokumentacionin e meposhtem:

1. Diplome, ose fotokopje te saj te njesuar me origjinalin, te ciklit te pare te studimeve te perfunduar ne Republiken e Shqiperise. Kandidatet qe kane perfunduar me sukses

studimet e ciklit te pare dhe kane shlyer te gjitha detyrimet e parashikuara per ciklin perkates te studimit konform kuadrit ligjor ne fuqi, por qe nuk disponojne ende kartonin e diplomes ne momentin e aplikimit, pajisen me dokument nga IAL-ja ku kane perfunduar studimet konform percaktimeve te pikes 4 te nenit 91 te ligjit nr. 80/2015, date 22.07.2015 "Per arsimin e larte dhe kerkimin shkencor ne institucionet e arsimit te larte ne Republiken e Shqiperise". Per diplomat e fituara jashte vendit, vertetimin e njohjes ne Republiken e Shqiperise, te leshuar nga MAS, diplomes se ciklit te pare te studimeve te perfunduar jashte vendit, shoqeruar me fotokopje diplomes te njesuar me origjinalin, ose ne mungese saj, te nje dokumenti tjetër zyrtar mbi bazen e te cilit eshte kryer njesimi ne Republiken e Shqiperise, te leshuar ne vendin ku ka kryer studimet, qe i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve universitare ne vendin perkates.

2. Diplomen e Matures Shteterore se bashku me certifikaten e notave ose fotokopje te tyre te njesuar me origjinalin, e konfirmuar nga njesia perkatese arsimore vendore (DAR/ZA). Kandidatet qe kane perfunduar shkollen e mesme perpara hyrjes ne fuqi vendimit nr. 876, date 3.11.2010 te Ministrave "Per disa ndryshime ne Vendimin nr. 78, date 8.2.2006 te Keshillit Ministrave "Per krijimin e Matures Shteterore dhe pranimet ne shkollat e larta publike", i ndryshuar, paraqesin Deftesen e Pjekurise (origjinal ose ne rast fotokopjeje te saj, njesuar me origjinalin, te konfirmuar nga njesia perkatese arsimore vendore DAR/ZA).

Ne qofte se kandidatet nuk posedojne deftese pjekurie te shkolles se mesme, duhet te paraqesin dublikate te defteses se pjekurise, leshuar nga drejtoria e shkolles se mesme ku ka perfunduar shkollen dhe te konfirmuar nga njesia perkatese arsimore vendore (DAR/ZA), ose dokumentin e leshuar nga Arkivi i Shtetit se bashku me listen e notave. Kandidatet qe kane kryer shkollen e mesme jashte vendit duhet te dorezojne dokumentin e njohjes te leshuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;

3. Formulari i aplikimit
4. Fotokopja e dokumentit te identifikimit (karte identiteti, leternjoflim ose pasaporte);
5. Dy fotografi personale.
6. Tarifa e aplikimit prej 2500 leke

Regjistrimet kryhen prane sekretarive mesimore çdo dite nga ora 08:00-16:00.

Gjirokastër, më 08.10.2016

Prof.dr.Bektash MEMA
REKTOR

